



EXPOCITY
ALBANIA

EXPOCITY 2023 AFTËSI KARRIERË & PUNËSIM FESTIVAL

Edicioni i Parë, 13-15 Dhjetor 2023

PSE NJË "FESTIVAL PËR PUNËN, AFTËSITË DHE KARRIERËN EXPO 2023"?

"Festival i Aftësive, Karrierës dhe Punës EXPO 2023" do të zhvillohet përgjatë 3 ditëve "13-15 Dhjetor 2023", në ambjentet e Expocity Albania si një festë dhe kontribut dedikuar aftësive, karrierës dhe punësimit në Shqipëri.

Përmes këtij edicioni të parë, festivali tre ditor i organizuar nga Expocity Albania dhe Albanian Skills, synojnë, të ndajnë dhe përcjellin informacionet e nevojshme për të gjithë pjesëmarrësit dhe vizitorët, të cilët janë të interesuar për të përmirësuar dhe diversifikuar karrierën e tyre. Aktivitetet e larmishme dedikuar të gjitha moshave do të rrisin aftësitë dhe kapacitetet individuale të tyre, si edhe të zhvillojnë kompetencat profesionale dhe personale të punonjësve të kompanisë/biznesit të tyre. Po ashtu, të gjithë punëkërkuarit dhe kompanitë që kanë mungesë të stafit do të mund të gjejnë gjithçka ju nevojitet: punën e shumëdëshiruar, punën e sigurt dhe të mirëpaguar, si edhe punonjës të kualifikuar dhe profesionalë dhe nga të gjitha drejtimet! Edicioni i 8-të i Konkurseve Kombëtare për të rinjtë e talentuar nga 16-25 vjeç në fushat e Teknologjisë dhe Informacionit, Mikëpritjes dhe Turizmit, Ekonomisë dhe Sipërmarrjes, Bukurisë dhe Kujdesit Shëndetësor do të vendosë kompanitë dhe bizneset pjesëmarrëse në festival në kontakt direkt me kandidatët potencialë të forcës punëtore të kualifikuar që kërkojnë.

Punëkërkuarit e moshave dhe profesioneve të ndryshme do të takohen me përfaqësues të kompanive më të mëdha të vendit, por edhe përtej. Gjithashtu do të njihen me ofertat më të reja të tregut të punës dhe me aftësitë që duhen zotëruar për të fituar dhe shkëlqyer në një pozicion pune.

Kategoritë e

EKSPOZUESVE

- Biznese
- Organizata
- Institucione
- Universitete
- Shkolla profesionale
- Institucione financiare
- Agjenci dhe portale punësimi

Do të orientohen mbi profilizimet që të mund të marrë karriera e tyre duke u njohur me aftësitë (soft skills & hard skills) që duhen përvetësuar për t'u përshtatur dhe integruar sa më mirë dhe shpejt me tregun dinamik të punës. Punëkërkuarit do të kenë mundësinë të kryejnë intervista të shpejta punësimi në mënyrë që të arrihet qëllimi final, punësimi i tyre në një kohë mjaft të shkurtër (nga kompanitë pjesëmarrëse dhe kompani punësimi të cilat do të jenë prezente gjatë panairit). Në këtë mënyrë, punëdhënësit, të cilët duan të rekrutojnë punonjës të rinj, do të gjejnë student dhe punëkërkuar të talentuar, profesionistë (me dhe pa përvojë), të cilët janë të gatshëm të bëhen pjesë e stafit të kompanisë/biznesit të tyre.

Gjatë tre ditëve kompanive pjesëmarrëse dhe të gjithë të interesuarve të cilët duan të kualifikohen ose të rikualifikohen për t'ju përshtatur kërkesave të shpejta të tregut të punës vendas dhe atij ndërkombëtar, do të kenë mundësinë të marrin shërbime të tilla si:

- ♦ Këshillim dhe orientim në karrierë
- ♦ Paketa trajnimesh profesionale, aftësimi dhe riaftësimi
- ♦ Seminare
- ♦ Punëtori
- ♦ Konferenca

Kategoritë e

VIZITORËVE

- Studentë dhe të sapodiplomuar që janë në kërkim të një vendi pune.
- Studentë që janë në kërkim të kompanisë/institucionit ku duan të bëjnë praktikën mësimore.
- Punëkërkuar dhe të punësuar të cilët duan të rrisin "soft & hard skills" për t'u përmirësuar dhe rritur profesionalisht.
- Biznese të reja ose të konsoliduara që janë në kërkim të talenteve të reja.
- Individë të moshës së mesme që nuk kanë një punë, ose duan të ndryshojnë pozicionin e punës.
- Prindër të cilët janë të interesuar për këshillim karriere për fëmijët e tyre.
- Të gjithë të interesuarit e tjerë që nuk janë përmendur më sipër.

PSE NUK DUHET TË MUNGONI NË KËTË EVENT?

Ky event do të nxjerrë në pah se investimi në aftësitë e duhura, është çelësi për rritjen e ekonomisë dhe se nëpërmjet ngritjes së aftësive dhe rikualifikimit, mund të hapen dyert e mundësive për arsim, trajnim dhe zhvillim profesional, duke çuar drejt një punësimi më të sigurt, sepse një fuqi punëtore me aftësi dhe mjeshtëri profesionale, kontribuon në rritjen e qëndrueshme të vendit, duke sjellë më shumë risi dhe duke përmirësuar konkurrencën mes kompanive.

Ju nuk duhet të mungoni në këtë event sepse do të keni mundësi të gjeni:

- ◆ Ofertat më të fundit të punës.
- ◆ Do të njiheni me kompanitë / institucionet më të mëdha në vend.
- ◆ Trajnime profesionale nga trajnues të shquar me përvojë kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushat më të kërkuara të tregut të punës.
- ◆ Do të zgjeroni rrjetin e kontakteve.
- ◆ Orientim mbi karrierën dhe të ardhmen profesionale.
- ◆ Histori suksesi të profesionistëve të njohur brenda dhe jashtë vendit, prej të cilëve mund të merni këshilla se si të ndërtoni të ardhmen tuaj profesionale.

PUNËKËRKUES

- 🔍 Orientoni & diversifikoni kërkimin tuaj për aftësim, punë dhe karrierë
- 🔍 Zbuloni mundësi të reja punësimi
- 🔍 Njihuni nga afër me rekrutuesit e sektorit publik, privat dhe ndërkombëtar
- 🔍 Mendoni për të mësuarin gjatë gjithë jetës, si mënyra e vetme për t'u përshtatur me një treg pune që është vazhdimisht në ndryshim
- 🔍 Motivohuni dhe informohuni nga trajnues profesionistë

PUNËMARRËS

- 👥 Zbuloni talente të reja për kompaninë ose institucionin tuaj.
- 👥 Këshillohuni rreth mënyrës së rekrutimit për punësim.
- 👥 Ulni kostot e rekrutimeve.
- 👥 Zhvilloni intervista të shpejta, në mënyrë që të përshpejtoni procesin e rekrutimit.
- 👥 Zgjeroni rrjetin e kontakteve dhe rrisni vizibilitetin e kompanisë tuaj.

ZONA E TRAJNIMEVE, AFTËSIMIT DHE RIAFTËSIMIT

I përkushtohet të gjitha moshave: fëmijëve, të rinjve/të rejave, burrave/grave që janë të interesuar për trajnime kualifikuese, përmirësim të aftësive personale dhe profesionale (soft & hard skills), të cilat do t'u shërbejnë dhe do t'i përgatisin ata për t'u fuqizuar në tregun dinamik të punës. Disa nga trajnimet më të kërkuara që do të gjeni në këtë event, janë:

- Marketingu dixhital
- Trajnimi i burimeve njerëzore
- Strategjitë e marketingut, shitjes dhe komunikimit dixhital
- Udhëheqja dhe sipërmarrja
- Zhvillim Webi, etj.

*Trajnimet profesionale do të shoqërohen me certifikata pjesëmarrjeje.

ZONA E EDUKIMIT

I përkushtohet të gjitha moshave: fëmijëve, të rinjve/të rejave, moshës së mesme dhe moshës së tretë, të cilët janë të etur për dije dhe informacion. Gjatë tre ditëve do të zhvillohen sesione këshillimi dhe orientimi mbi karrierën, konferenca, forume, konkurse etj.

ZONA B2B

Është zona dedikuar takimeve dhe intervistave të shpejta midis punëdhënësve dhe punëmarrësve, si dhe zona ku do të zhvillohen aktivitete të tjera të larmishme të lidhura me aftësimin, punësimin, karrierën dhe të mësuarin gjatë gjithë jetës.

ZONA E SUKSESIT

Në këtë zonë do të jenë të ftuar personazhe të njohur të botës së biznesit, teknologjisë, akademike etj, të cilët do të ndajnë historitë e tyre të suksesit përmes rrugëtimit dhe rritjes profesionale brenda dhe jashtë vendit.

PUNËSIM

Eja në Expo dhe zgjidh të ardhmen tënde (punën që të përshtatet)!

Tregjet e punës janë sisteme komplekse ku kërkohet ose ofrohet puna. Në mënyrë që këto të bashkëveprojnë siç duhet, nevojitet asistencë nga mekanizma të ndryshëm që ofrojnë shërbime punësimi. Për këtë shërben dhe festivali i punës, si një mjet i rëndësishëm në këtë drejtim, pasi tregu shqiptar i punës është duke u përballur me vështirësi në gjetjen e punonjësve, dhe nga ana tjetër, punëkërkuarit nuk gjejnë punën që dëshirojnë.



KARRIERË

Gjej çelësin për të hapur dyert e karrierës dhe mos e lër të ardhmen tënde pa vizion!

Nxënësit e arsimit 9-vjeçar, të mesëm dhe atij të lartë, janë duke hasur vështirësi në zgjedhjen e drejtimin të duhur për t'u përshtatur me tregun dinamik të profesioneve. Të sapodiplomuarit dhe të punësuarit, të cilët duan të ndryshojnë dhe diversifikojnë karrierën e tyre, janë në dilemë se drejt cilës zgjedhje duhet të shkojnë, në përshtatje me transformimin dixhital, zhvillimet globale dhe ndryshimet e shpejta teknologjike, ekonomike, politike e sociale dhe ndikimin që ato kanë në tregun e punës.

Për këtë arsye, përgjatë tre ditëve të panairit, do të ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës, i cili do të ketë në fokus ndihmën, orientimin dhe drejtimin e të gjithë individëve të interesuar në mundësitë e zhvillimit të karrierës dhe marrjen e vendimeve realiste për të ardhmen.

Kush mund të marri pjesë?

- 1 Prindër
- 2 Fëmijë
- 3 Studentë
- 4 Punonjës
- 5 Punëkërkuar
- 6 Të gjithë të interesuarit e tjerë

KONKURSE PROFESIONALE ALBANIAN SKILLS

Shoqata Kombëtare për Konkursat e Aftësive, është një platformë novatore për promovimin dhe zhvillimin e aftësive. Që nga viti 2015, shtatë edicione për garat e aftësive, kanë mbledhur qindra të rinj si konkurrues dhe juri profesionale nga sektori privat, të cilët mbidhen bashkë për të zhvilluar dhe promovuar aftësitë profesionale. Konkurrentët janë të rinj të talentuar të moshës 16-25 vjeç nga të gjitha zonat gjeografike të vendit, si studentë, të punësuar apo të papunë që kanë piktuar profesione, të cilët aplikojnë për pjesëmarrje në garat kombëtare të aftësive çdo vit.

Qëllimi i Konkurseve Kombëtare të Aftësive Shqiptare, është promovimi i aftësive dhe për rrjedhojë, përmirësimi i njohjes dhe statusit të arsimit dhe formimit profesional në shoqërinë shqiptare.

Misioni i këtyre konkurseve është përfaqësimi në arenën ndërkombëtare, duke i çuar pjesëmarrësit në organizime europiane dhe botërore të konkurseve profesionale si EuroSkills dhe WorldSkills. Albanian Skills pati kënaqësinë të dërgojë dy ekipe në EuroSkills për edicionin final, në kategorinë Konkursi i Sipërmarrjes/Zhvillimit të Biznesit. Në këtë kategori, Shqipëria u përfshi si vend mysafir së bashku me Tajlandën dhe Emiratet e Bashkuara Arabe.

EDICIONI I TETË I KONKURSEVE KOMBËTARE TË AFTËSIVE SHQIPTARE

Më 13 -15 dhjetor 2023, Edicioni 8-të i Konkurseve Kombëtare të Aftësive për të Rinjtë në Shqipëri, këtë herë do të vijë me një format tërësisht të ri të organizuar për herë të parë në Shqipëri, në kuadër të Vitit Europian të Aftësive, përmes Festivalit të Aftësive, Karrierës dhe Punës 2023.

Ky event do të bashkojë të gjithë aktorët që punojnë dhe kontribuojnë në aftësimin e fuqisë punëtore në Shqipëri, duke ndihmuar në zhvillimin e karrierës dhe punësimit të tyre, dhe duke përfshirë gjithashtu fëmijët dhe të rriturit.

Çdo individ i rritur apo i moshuar, institucion, biznes dhe kompani, do të ketë shumë arsye për të marrë pjesë, vizituar dhe përfituar nga larmia e një kalendari aktivitetesh, nga konkursat profesionale të aftësive, intervistat dhe punësimet e shpejta, tek trajnimet e burimeve njerëzore, edukimi për karrierë, forumet profesionale dhe kualifikimet, konferencat dhe rrjetëzimet, etj.

The competition categories will be:


1. Konkursi i Sipërmarrjes dhe Zhvillimit të Biznesit
2. Konkursi i Shërbimit të Hoteleve dhe Restoranteve
3. Konkursi i Dizajnit Grafik
4. Konkursi i Fotografisë
5. Konkursi për Zhvillimin e Softuerit
6. Konkursi për Zhvillimin e Uebit
7. Konkursi i Marketingut Dixhital
8. Konkursi Parukier & Berber


KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHA KONKURSET:

- 1** Duhet të jeni midis moshës 16 dhe 25 vjeç (në datën e konkursit).
- 2** Duhet të plotësoni kërkesat specifike të konkursit përkatës (shih më poshtë).
- 3** Aplikimet e shumta për konkurse të ndryshme nuk janë të mundura, sepse të gjitha garat zhvillohen në të njëjtën ditë. Në rast aplikimesh të shumta, ne konsiderojmë të vlefshëm vetëm aplikacionin e paraqitur të parin.
- 4** Konkurrentët do të përzgjidhen nga juria e konkursit përkatës. Kriteret e përzgjedhjes janë përvoja juaj në fushën përkatëse të konkursit, motivimi i shprehur në formularin e aplikimit dhe një përzierje e barazpeshuar gjinore e pjesëmarrësve, nga rajone të ndryshme të Shqipërisë, si dhe nga kompani dhe shkolla të ndryshme.
- 5** Aplikimet e pjesëmarrësve nga vitet e mëparshme, janë të mirëpritura. Megjithatë, në rastin e një numri të madh aplikimesh të reja të përshtatshme, përparësi u jepet atyre që nuk kanë marrë pjesë kurrë në Albanian Skills.
- 6** Aplikimi dhe pjesëmarrja është pa pagesë.

Për informacione të vazhdueshme, mund të ndiqni Albanian Skills në rrjetet sociale të mëposhtme:

 albanianskills@gmail.com

 www.albanianskills.org

 facebook.com/albanianskills

 instagram.com/albanianskills

 linkedin.com/albanianskills

LISTA E ÇMIMEVE

PAKETA PARTNERE

	PARTNER SILVER	PARTNER GOLD	PARTNER PLATINIUM	PAKETA PËRFSHIN:
	€ 5,000	€ 7,000	€ 10,000	ÇMIMI I PAKETËS
	35 m ²	50m ²	70 m ²	Hapësira premium për ekspozuesit
				Emri i kompanisë në panelin ballor të stendës
	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	Stenda (2 tavolina, 4 karrige, furnizim me energji elektrike për ndriçim dhe lidhje WIFI)
	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	Prezantimi i kompanisë gjatë forunit/konferencës
	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	Logoja e kompanisë në banerin e eventit në faqen online të Expocity
	1 faqe	2 faqe	2 faqe	Logoja e kompanisë në kopertinën e katalogut
	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	Logoja e kompanisë në ftesa të personalizuar
	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	Hapësirë ekskluzive për takime B2B
		<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	Banera promocoionale për rrjete sociale
			<input checked="" type="checkbox"/>	Prezantime si "Krye-Sponsor" në fushatën e reklamimit
			<input checked="" type="checkbox"/>	Broshurat e kompanisë brenda dosjeve të konferencës /workshop-it
			<input checked="" type="checkbox"/>	Logoja e kompanisë në spotin promocoional të eventit
			<input checked="" type="checkbox"/>	Baneri i kompanisë në fasadën e Expocity (dimensionet 5.43x1.6)
			<input checked="" type="checkbox"/>	Përshkrimi i kompanisë në artikujt mediatikë të eventeve

STENDA STANDARTE

Emrin e printuar të kompanisë
 Panele MDF, 2.5 m lartësi
 Tapet një përdorim
 1 Tavolinë, 2 karrige
 Energji elektrike dhe ndriçim
 Wi-Fi

ÇMIMI: 96 euro/m² (TVSH E PËRFSHIRË)





EXPONEX 2023 AFTËSI KARRIERË & PUNËSIM FESTIVAL

Edicioni i Parë, 13-15 Dhjetor 2023

Expocity Albania është organizues u Panairëve dhe Konferencave Kombëtare dhe Ndërkombëtare, i çertifikuar nga UFI, specializuar në organizimin dhe zhvillimin e panairëve, ekspozitave dhe eventeve të ndryshme të biznesit, drejtuar tregut vendor dhe atij ndërkombëtar. Expocity Albania u ofron pjesëmarrësve në këto aktivitete, një strukturë dhe infrastrukturë të plotë, bashkëkohore dhe të plotësuar me të gjitha lehtësitë dhe stafin e nevojshëm. Këto bashkë me 5'000 m2 hapësirë të brëndshme, 7'000 m2 hapësirë të jashtme, 800 vende parkimi, e bëjnë Expocity Albania platformën më komplekse dhe më të përshtatshme për realizimin me sukses të këtij lloj komunikimi në Shqipëri. Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Tiranë, Shqipëri.



Menaxhere Projekti

Silvana Mazniku

silvana.mazniku@expocity.al

+355 69 684 1894



067 770 0077

info@expocity.al

www.expocity.al